

Vaksina kundër COVID-19 në Massachusetts, për banorët e moshës 65 vjeç e lart



Që nga data 18 shkurt, 2021, personat e moshave 65 vjeç e lart në Massachusetts mund të fillojnë ta bëjnë vaksinën COVID-19. Vaksina kundër COVID-19 është e sigurt dhe falas.

Kur mund ta bëj vaksinën?

Vaksinimet për persona të moshave 65 vjeç e lart do të fillojnë më 18 shkurt 2021 dhe do të vazhdojnë të ofrohen gjatë dimrit dhe pastaj në pranverë dhe në verë. Të gjithë këta persona mund të lënë takime vaksinimi, duke filluar nga data 18 shkurt 2021.

Vaksinat e tanishme kundër COVID-19 kërkojnë dy doza. Ju nuk mund të konsideroheni se jeni vaksinuar plotësisht, derisa t'i keni bërë të dyja dozat, dhe të dyja dozat duhen bërë tek i njëjti vend.

Kush përfiton

Personat e moshës 65 vjeç e lart përfitojnë për ta bërë vaksinën, duke filluar nga data 18 shkurt 2021. **Kini parasysh se, për shkak të kërkesës së lartë dhe furnizimit të kufizuar, mund t'ju duhet të prisni disa javë për një vizitë te një qendër vaksinimi afër jush.** Dora-dorës që shteti i Massachusetts-it furnizohet me sasi të mëtjeshme vaksinash, do ta keni më të lehtë për të lënë takime vaksinimi.

Si mund ta rezervoj një takim?

Takimet mund të planëzohen online, duke vizituar vaxfinder.mass.gov. Të interesuarit mund të futin kodin ZIP ose emrin e qytetit/lokalitetit ku banojnë, për të gjetur një takim online. Edhe pse ka shumë kërkesa për vaksinim dhe furnizimet me vaksina mbeten të kufizuara, në uebsajt do të shtohen vazhdimisht takime të reja dhe qendrat e vaksinimit masiv do të vënë më shumë orare vaksinimi në dispozicion. Hë për hë, qendrat e vaksinimit masiv i publikojnë oraret e lira për takime çdo javë, të enjteve, ndërsa disa qendra më të vogla, si CVS, edhe më rregullisht. Nëse ju nuk arrini të siguronit një takim, vazhdoni të kontrolloni uebsajtin.

Për të rezervuar një takim:

1. Vizitoni vaxfinder.mass.gov
2. Futni kodin ZIP ose qytetin/lokalitetin ku banoni, për të gjetur një qendër vaksinimi
3. Mbani me vete informacion të rëndësishëm për ju, të tillë si kartën e sigurimeve mjekësore
4. Mbushni formularin e vetë-certifikimit, si pjesë e procesit të rezervimit të takimit.

Pikat ku mund të vaksinoheni

Ka disa vende ku personat e moshës 65 vjeç e lart mund të vaksinohen. Meqë dozat e vaksinës janë në sasi të kufizuar, **mund t'ju duhet të prisni disa javë, para se të siguronit një vizitë.**

Vizitoni [faqen me qendrat e vaksinimit në ueb](#) të Commonwealth-it, për listën e qendrave aktualisht të hapura, përfshi:

1. **Qendrat e vaksinimit në masë**, si ato në Gillette Stadium, Fenway Park, Eastfield Mall në Springfield, DoubleTree Hilton Hotel në Danvers, Reggie Lewis Center në Roxbury dhe të tjera. Këto qendra aktualisht ofrojnë edhe më shumë mundësi për takime;
2. **Klinika vaksinimi** rajonale, që menaxhohen nga një bord shëndetësor lokal;
3. **Mbi 100 farmaci lokale** dhe dyqane që e ofrojnë vaksinën; ose
4. **Institucioni që ju ofron strehim**. Në qoftë se jetoni në një [institucion strehimi publik ose privat për të moshuar me të ardhura të pakta](#), ky mund të jetë duke planëzuar një klinikë vaksinimi brenda institucionit, prandaj pyetni kompaninë menaxhuese.

Mbani parasysh se kjo listë do të përditësohet shpesh, dora-dorës që qendra të reja bëhen aktive. **Të gjitha qendrat e vaksinimit në masë ofrojnë akses për karrige me rrota dhe vizitorët nuk janë të detyruar të ngjitin shkallë.** Shumë nga këto qendra ofrojnë lehtësi për persona që nuk ecin dot për distanca të gjata dhe për persona që nuk presin dot gjatë në radhë përjashta. Disa qendra mund të ofrojnë edhe ndihmë me lëvizjen. **Shërbime përkthimi ofrohen për të gjitha qendrat e vaksinimit në masë dhe shumë vende të tjera vaksinimi.** Shqyrtoni të dhënat e ofruara për çdo qendër specifike vaksinimi, për të verifikuar nëse ju përshtatet nevojave tuaja.

[Ndihmë për caktimin e një vizite](#)

Personat që **nuk janë në gjendje ta përdorin ose e kanë të vështirë aksesin në Internet** për të planëzuar një vizitë online, mund të përdorin ***Linjën e Planëzimit të Vaksinës në Massachusetts:***

Telefononi te 2-1-1 (877-211-6277)
dhe ndiqni mesazhet e gatishmërisë për ndihmë me rezervimin e një takimi

Orët e Funkionimit:

E hënë – E enjte 8:30 AM deri 8:00 PM

E premte – E diel 8:30 AM deri 5:00 PM

Linja e Planëzimit të Vaksinës në Massachusetts ofrohet në anglishte dhe spanjishte dhe do të ketë përkthyes në dispozicion për të ndihmuar banorët, në rreth 100 gjuhë të tjera. Personat e interesuar do të mund të flasim me një përfaqësues në telefon, që do t'i ndihmojë për të rezervuar një takim, përmes sistemit online të shtetit. **Këta përfaqësues kanë akses të njëjtë te takimet si në uebsajtin publik dhe nuk do të ofrojnë akses në më shumë takime.** Nëse nuk ka orare të lira takimesh në dispozicion, telefonuesve do t'u jepet opsioni që të shtohen në një listë telefonimi për qendra të vaksinimit masiv. Ashtu dikush do t'u telefonojë, sapo të krijohet mundësia për një takim në një qendër vaksinimi masiv dhe lista do të përdoret për t'i renditur thirrjet sipas radhës kur janë regjistruar.

Disa burime të tjera që mund t'ju ndihmojnë, përfshijnë organizatat lokale të mëposhtme:

- [Këshilli lokal për të moshuarit ose Qendra për të moshuarit](#)
- Pika aksesit shërbimesh rajonale për të moshuarit ([ASAP](#))

Commonwealth-i zotohet që t'u sigurojë akses te vaksina të gjithë atyre që përfitojnë, por që kanë nevojë për një ambulancë ose për të paktën dy vetë që t'i ndihmojnë për të dalë nga

shtëpia dhe për të shkuar te qendra e vaksinimit. Së shpejti do të vëmë në dispozicion informacion të mëtejshëm për opsionet e vaksinimit, për këta persona. Mbani parasysh se disa persona mund të përfitojnë nga vakcina, në qoftë se jetojnë në një institucion strehimi për të moshuar me të ardhura të pakta, ku mund të jetë planëzuar hapja e një klinike brenda institucionit.

Kriteret për të përfituar

Kur organizoni vizitën tuaj ose në momentin e vizitës, do t'ju kërkohet të shqyrtoni kriteret e përfitimit dhe të konfirmoni se ju jeni të kualifikuar për vaksinim. Ky certifikim do të bëhet gojarisht në telefon, gojarisht ose me shkrim te qendra e vaksinimit ose online, në qoftë se ju përdorni një vegël të planëzimit të vizitës online. Mund edhe të ndiqni udhëzimet online dhe të plotësoni dhe të plotësoni formularin [COVID-19 Massachusetts Vaccination Attestation Form që ofrohet në uebsajtin mass.gov](#).

Mund ta bëni vaksinën edhe po të mos keni sigurime mjekësore, një SSN ose një kartë ID me foto. Megjithatë, po të keni ndonjë nga këto dokumente ose të dhëna, sillini me vete.

Asnjëherë nuk do t'ju kërkohet numër karte krediti ose ndonjë formë tjetër pagese për vaksinën.

Rëndësia dhe siguria e vaksinës kundër COVID-19

Vaksinat kundër COVID-19 janë të sigurta. Vaksinat ekzistuese kundër COVID-19 janë miratuar dhe rekomanduar nga FDA-ja dhe Komiteti Këshillimor për Praktikën e Imunizimit i CDC-së, në bazë procesesh standard të testimit dhe të miratimit. Vaksinat u nënshtrohen testeve rigoroze dhe provave klinike masive me pjesëmarrës të ndryshëm, para se të miratohen për përdorim të gjerë. Vaksinimi është mënyra më e mirë që të reduktohet rreziku për t'u sëmurur rëndë me COVID-19. Vaksinimi mund edhe të mbrojë të tjerët rreth jush, që ende nuk e kanë bërë vaksinën. Për më shumë rreth sigurisë së vaksinës, vizitoni [mass.gov/covidvaccinesafety](https://www.mass.gov/covidvaccinesafety).

Vaksina ka rezultuar tejet e sigurt, por ka rëndësi që të gjithë banorët të praktikojnë parandalimin, deri kur t'i marrin të dyja dozat dhe trupi i tyre të ndërtojë imunitetin. Edhe pse vaksinat janë treguar të efektshme për të penguar që personi i vaksinuar të sëmurë rëndë nga COVID-19, mbetet për t'u provuar që ato njëkohësisht reduktojnë gjasat që ky person t'ua ngjitë COVID-19 të tjerëve. Vazhdoni të ruani distancimin social, mbani maskë, shmangni grupet dhe rritni në shtëpi, po të ndiheni pa qejf.

Po të keni shqetësime në lidhje me vaksinimin, për shkak të ndonjë problemi shëndetësor tuajin, diskutojini këto shqetësime me mjekun tuaj të kujdesit parësor. Për më shumë informacion rreth sigurisë së vaksinës kundër COVID-19, vizitoni www.mass.gov/COVIDVaccineSafety.

Informacion i mëtejshëm

Informacioni për vaksinën kundër COVID-19 do të përditësohet rregullisht. Përdorni edhe burimet e mëposhtme:

- [Informacion për vaksinën kundër COVID-19 në Massachusetts](#)

- [Përditësimet më të fundit për vaksinën kundër COVID-19 në Massachusetts](#)
- [Kalendari i shpërndarjes dhe përfitueshmëria ndaj vaksinës kundër COVID-19](#)
- [Qendrat e tanishme të vaksinimit kundër COVID-19](#)
- [Programi i vaksinimit kundër COVID-19 në Massachusetts \(MCVP\)](#)
- [Informacion për personelin dhe banorët e institucioneve të strehimit afatgjatë, ALR-ve dhe shtëpive të konvaleshencës](#)
- [Informacion për banorët dhe personelin e institucioneve të strehimit për të moshuar me të ardhura të pakta](#)
- [Informacion për punonjësit e shëndetit në shtëpi](#)
- [Pyetje që bëhen shpesh për vaksinën kundër COVID-19](#)
- [Siguria e vaksinës kundër COVID-19](#)
- [Regjistrohuni për të marrë sinjalizime rreth COVID-19](#)